



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar””

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Reme Lala, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Ervin Bushati, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Lavdrim Sahitaj – Drejtor i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Artemon Cukalla – Drejtor i Drejtorisë së Pagesave të Dëmshpërblimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Saida Turabi – përgjegjëse e sektorit të Drejtorisë së Legjislacionit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Alba Ago – specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Sot në rendin e ditës së punës së këtij komisioni kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar”.

Relatore e këtij projektligji është zonja Evis Kushi.

Për të prezantuar dhe mbrojtur projektligjin para këtij komisioni ndodhet ministri për Financat edhe Ekonominë, zoti Arben Ahmetaj.

Do të procedojmë me zotin ministër dhe më pas me relatoren e komisionit.

Zoti Ahmetaj, e keni ju fjalën.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe komisionit!

Do të mundohem ta përmbledh fjalën time shkurt duke ndarë me ju thelbin e ndryshimeve, njëkohësisht duke sjellë edhe disa statistika të rëndësishme për t'i ndarë me qytetarët, si dhe ecurinë e këtij procesi ndër vite.

Përgjatë harkut kohor 2009-2018 janë miratuar rreth 13 mijë e 101 dosje të aplikuara nga ish-të përndjekurit politikë. Ndërkohë, në retrospektivë financiare, praktikisht janë shpërndarë deri tani 8 këste për kategorinë parësore. Për shkak të kufizimeve ligjore të kësteve jo më i madh se 1 milion dhe jo më i vogël se 100 mijë, sigurisht, duke iu referuar shumës përfituese ligjore, një pjesë ka ngelur në nevojë të këstit të nëntë, mirëpo ligji kufizonte këstin e tetë, kështu që nëpërmjet këtyre ndryshimeve ne po bëjmë të mundur që kategoritë parësore dhe joparësore, që janë, në mos gaboj, rreth 1200 dosje, do të përfitojnë nga ky ndryshim ligjor. Çfarë do të thotë kjo? Nëpërmjet këstit të nëntë do të mbyllim gjithë pjesën e kategorisë parësore, pra ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dënimin.

Ka pasur një debat të gjatë edhe brenda parlamentit për sa i përket çështjes se çfarë ka ndodhur me ish-të përndjekurit politikë dhe unë dua të ndaj me ju disa shifra të rëndësishme, të cilat tregojnë se çfarë ka ndodhur me ta.

Po të vini re, në vitet elektorale 2009-2013, gjithmonë ish-qeveria ka tentuar të përdorë buxhetin e shtetit me emocione elektorale ndaj këtij grupi. Që nga viti 2010 deri në vitin 2013

janë shpërndarë 7.9 miliardë lekë. Që nga viti 2014 deri në vitin 2018, në 4 vjet janë shpërndarë 9.1 miliardë lekë.

Për sa i përket kategorisë së parësorëve, që është shumë e ndjeshme dhe e rëndësishme, pasi u referohemi gjithmonë pjesës së ish-të përndjekurve politikë që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dënimin, në periudhën 2009-2013, kësaj kategorie i është dhënë vetëm 1.5 miliardë lekë. Pra, nëse për thjeshtësi do t'i referohesha për lehtësi krahasuese, i bie 15 milionë dollarë në 4 vjet. Në periudhën 2014-2018 kategorisë parësore i është dhënë 7.07 miliardë lekë, pra 70 milionë dollarë. Ky krahasim tregon drejtpërsëdrejti edhe kujdesin që ka kjo maxhorancë edhe ndaj kësaj kategorie, që ka vuajtur në regjimin komunist.

Shifrat janë kokëfortë, të thatë, për të treguar edhe të vërtetën e atij debati politik se çfarë i bën njëra palë kësaj kategorie që ka vuajtur në regjimin komunist dhe çfarë i ka bërë pala tjetër. Këta janë njerëz dhe familje që kanë vuajtur dhe boloria politike vetëm ua pështiros, por e vërteta është e thatë dhe e drejtpërdrejtë. Ata që dikur kanë mbajtur flamurin se kanë mbështetur këtë kategori, atyre që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti në regjimin komunist, u kanë dhënë vetëm 15 milionë dollarë, ua kanë mohuar të drejtën, ndërsa sot, brenda mandatit të parë të qeverisë “Rama”, kanë marrë 70 milionë dollarë.

Ndryshimi i dytë që paraqesim në ligj, që është ndryshim themelor, është ndryshimi i raportit midis parësorëve në 70 me 30, duke i dhënë përparësi kategorisë parësore. Për këtë çështje nuk dua të bëj shumë politikë, sepse ne do të vazhdojmë me parësorët dhe do ta paguajmë të gjithë kategorinë parësore për ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti nga regjimi komunist, por e mendova si të domosdoshme që t'i drejtohesha kësaj kategorie pasi parti politike të ndryshme tentojnë ta përdorin edhe emocionalisht. Vuajtja ka qenë e madhe, por e vërteta është se Partia Demokratike, që pretendon se i ka mbështetur u ka dhënë vetëm 15 milionë. Ne andej nga Jugu kemi një shprehje zhargon: “U kanë tharë zorrën”, ndërsa “Rama 1” e ka furnizuar të drejtën e tyre ligjore me 17 milionë dollarë. Këtu po ndaloj së bëri politikë, duke shpresuar që komisioni dhe parlamenti do ta mbështesin ndryshimin. Faleminderit!

Erion Braçe – Zonja Kushi e ka fjalën.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për shpjegimet tuaja!

Projektligji i sotëm synon përmirësimin e formulës së dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist, për të siguruar një mbështetje më të mirë financiare për

personat që kanë vuajtur dënimin dhe që janë ende në jetë apo për familjarët e tyre, si edhe për ta përsheptuar dhe për ta përfunduar sa më parë këtë proces. Ky projektligj synon të realizojë një ndër objektivat e programit të qeverisë, i cili u kushton një vëmendje të veçantë ish-të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre. Programi parashikon përfundimin e dëmshpërblimit të kësaj kategorie gjatë mandatit të dytë të kësaj qeverie, si dhe mbështet integrimin dhe pjesëmarrjen e tyre në çështjet shoqërore, ekonomike dhe politike. Buxheti i vitit 2018 siguron mbështetjen e nevojshme financiare për dëmshpërblimin e ish-të dënuar politikë, por meqenëse ky projektligj ka pasur debate në medie, madje edhe deklarata nga ana e opozitës, po ndalem më hollësisht në të gjitha ato pikë që përbëjnë ndryshim nga ligji ekzistues.

Së pari, rishikohet mekanizmi i shpërndarjes së fondeve, duke i dhënë prioritet likuidimit të plotë të ish-të dënuarve politikë që janë ende në jetë dhe subjekteve të tjera të kategorisë parësore. Sipas ligjit ekzistues që sot është në fuqi masa e dëmshpërblimit ndahet në mënyrë proporcionale në një raport prej 70% për subjektet përfituese parësore, që do të thotë bashkëshorti dhe fëmijët, dhe 30% për trashëgimtarët e tjerë, siç mund të jenë prindërit, vëllezërit, motrat apo fëmijët e tyre. Familjarët në shkallë të parë përjashtojnë familjarët e tjetër.

Projektligji i sotëm e heq këtë raport dhe parashikon që dëmshpërblimi të ndahet në mënyrë proporcionale midis gjithë përfituesve. Gjithashtu, në ligjin ekzistues theksohet se kësti i dëmshpërblimit duhet të jetë jo më i vogël se 100 mijë lekë dhe jo më i madh se 1 milion lekë, ndërkohë projektligji i sotëm e heq kufirin e poshtëm prej 100 mijë lekësh. Sipas relacionit të projektligjit dëmshpërblimi për subjektet parësore është realizuar në masën 90% dhe mbetet një diferencë e vogël e palikujduar. Masat që propozohen me këtë projektligj do të sjellin ritme më të shpejta të shpërndarjes së dëmshpërblimit dhe të përmbylljes së këtij procesi.

Së dyti, krijohet mundësia që të gjitha subjektet përfituese parësore, të cilave u takon një vlerë totale dëmshpërblimi mbi 8 milionë lekë, ta përfitojnë të gjithë shumën e dëmshpërblimit. Sipas ligjit ekzistues, i cili është ende në fuqi, këtyre subjekteve u kufizohet dëmshpërblimi deri në 8 milionë lekë, pra 8 kështe herë 1 milionë lekë, ndërsa projektligji i sotëm parashikon vijimin e shpërndarjes së dëmshpërblimit në kështe deri në shpërndarjen e plotë të tij.

Së treti, krijohet mundësia që, kur vlera totale e dëmshpërblimit e miratuar për të gjithë përfituesit është 1 milion lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit të kryhet e plotë në një kësht të vetëm.

Së katërti, dëmshpërblimi financiar ndërpritet me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë. Në këtë rast, duke qenë se dëmshpërblimi është e drejtë pasurore jovetjake dhe nuk zbatohen dispozitat e Kodit Civil, masa e dëmshpërblimit derdhet në buxhetin e shtetit. Ky rregullim ligjor qartëson procesin e dëmshpërblimit dhe ndikon në përdorimin me ekonomi, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike që është dhe një ndër parimet e sistemit tonë buxhetor.

Së fundi, krijohet mundësia që në raste gabimesh në llogaritjen e masës së dëmshpërblimit, të bëhen korrigjimet e nevojshme nga Këshilli i Ministrave. Projektligji nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit. Duke u mbështetur në të gjitha argumentet e mësipërme i propozoj komisionit miratimin e projektligjit. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi!

A ka pyetje për projektligjin?

Zoti Ministër, unë kam disa pyetje. Ky është ndryshimi i disatë që i bëhet këtij ligji. Në kohë të ndryshme, të gjithë ata që kanë dashur t'i bëjnë bisht këtij procesi, kanë bërë ndryshime në ligj dhe nuk janë këtu sot. Është një moment i mirë për të bërë një inventar. Ju përmendët që gjatë të gjithë periudhës janë miratuar ose njohur 13 mijë dosje. Interesi im ka të bëjë me faktin për të ditur sa është paguar deri tani nga buxheti i shtetit, nga pasuria publike e këtij vendi përmes proceseve të ndryshme, përfshirë edhe privatizimin, edhe privatizimin me letra me vlerë për këtë kategori shoqërore që nga dita që ka nisur ky proces e deri më sot?

Së dyti, ju thoni që prioritet do të ketë kategoria parësore, dhe është afërmendsh që kjo duhet të jetë kategoria që duhet të marrë nga buxheti i shtetit atë detyrim që është përcaktuar me ligj, për sa kohë që është gjallë. A mund të më thoni sa është kjo kategori? Sa kanë përfituar deri tani dhe çfarë ka mbetur për t'u paguar?

Së treti, për kategorinë tjetër, që janë trashëgimtarët, do të doja të dija sa është vlera që ka mbetur si detyrim për të paguar për trashëgimtarët? Në rast se më lejohet, desha t'ju pyes deri në cilin nivel trashëgimtarësh do të paguhet?

Të gjitha pyetjet kanë një sens, zoti Ministër, ne kemi njohur si shoqëri çfarë ka ndodhur gjatë periudhës së diktaturës, me akte të veçanta dhe pa më të voglin diskutim i është njohur e drejta për dëmshpërblim secilit nga personat që ka vuajtur burgim të padrejtë në diktaturë, por ajo që po paguan është shoqëria dhe, për sa kohë po paguan shoqëria përmes buxhetit të shtetit, do të duhet që të ketë transparencë për shumat e paguara deri tani dhe për detyrimet që mbeten,

me qëllim që gjithkush që kontribuon në buxhetin e shtetit të dijë se çfarë do të paguajë për vitet në vijim.

Arben Ahmetaj – Unë do ta nis nga pyetja që në këndvështrimin tim ka më shumë rëndësi për publikun, e cila ka të bëjë me shumën totale të paguar, pra nëse ecim me përpikëri, ndër 10-15 vjetët që do të vijnë, sa do të paguajnë brezat e ardhshëm për vuajtjet e brezave të kaluar? Deri sot janë paguar 17,8 miliardë lekë, 178 milionë dollarë. Jam duke folur për lekë në llogari bankare ose xhepat e kësaj kategorie. Sa bono privatizimi ka përdorur kjo kategori nuk e kam këtë shifër, është e vështirë ta kalkulojmë, por ju premtoj që deri në kalimin e ligjit, që besoj kalon të enjten, ju do ta keni këtë shifër. Janë harxhuar 178 milionë dollarë për këtë kategori për të paguar këstet. Për strehimin e çifteve të reja kemi harxhuar 20-25 milionë dollarë.

Nëse do të vazhdojmë, brezat që vijnë vetëm për këtë kategori për trashëgimtarët do të paguajnë të paktën edhe 500 milionë dollarë të tjerë trashëgimtarëve, gjithashtu për vuajtjet e një brezi të kaluar, që do të thotë shumat që shoqëria shqiptare do të paguajë shkojnë diku nga 65 miliardë deri në 70 miliardë, pra nga 650 milionë dollarë deri në 750 milionë dollarë. Nëse do të sillja në vëmendjen tuaj edhe një faturë potencialisht të materializueshme në dekadën që vjen, që ka të bëjë me ish-pronarët brezi i ri që vjen do të paguajë të paktën po kaq shumë për ish-pronarët. Kjo do të thotë se brezi i ri i shqiptarëve që vjen do të paguajë nga 1,5 deri në 2 miliardë dollarë nga taksat e tij për çfarë ka ndodhur që nga viti 1945 dhe deri në vitin 1989. Brezi që vjen do të paguajë gati 1,5 deri në 2 miliardë dollarë, në 8-15 vjetët që vijnë nga taksat e tij brezi që sot është 16-20 vjeç, sa do të fillojë punë do të paguajë taksa për çfarë ka ndodhur në këtë vend që nga vitit 1945 dhe deri në vitin 1989. Nuk po mbaj qëndrim nëse është e drejtë apo e gabuar, se nuk e kam unë këtë të drejtë të mbaj qëndrim nëse është e drejtë apo e gabuar, por dua të ndaj me ju se kjo kosto, po i kalohet brezit aktual dhe brezit që vjen. Kjo ishte përgjigjja pak më e zgjeruar e pyetjes suaj të parë.

Për pyetjen tjetër, për bonot e privatizimit, ju kërkoj ndjesë se nuk jam në gjendje të jap ndonjë përgjigje të kualifikuar statistikore tani, por besoj se deri pasnesër do t'ju sjellim edhe zyrtarisht. Për sa i përket këstit të nëntë, janë edhe rreth 1200 subjekte parësorë dhe jo parësorë.

Erion Braçe - Mua më intereson se sa janë parësorë.

Arben Ahmetaj –Parësorë, në mos gaboju me shifër janë 262. Janë të identifikuar. Për shembull, Sherif Merdani, në respekt të tij, i kërkoj ndjesë që i përmend emrin është një nga

personat që përfiton nga kësti i nëntë, që në të drejtën e tij legjitime, duke përfaqësuar edhe shoqatën, ka ngulur këmbë, është ulur me Kryeministrin e vendit, është ulur me personat përgjegjës për këtë punë dhe kemi arritur në këtë konkluzion për të bërë ndryshimin e ligjit. Pra, janë 262 subjekte parësorë.

Erion Braçe - Sa është detyrimi që duhet të paguajmë për ta?

Arben Ahmetaj - Me përafërsi duhet të shkojë diçka, në mos gaboj, te 250-300 milionë.

Erion Braçe- Me këtë mbyllet përfundimisht shlyerja e të gjithë kategorisë parësore?

Arben Ahmetaj – Besojmë se po, me dosjet që janë filtruar aktualisht.

Erion Braçe- Dakord. Për pjesën e trashëgimtarëve, dua të di sa janë trashëgimtarë të rrethit të parë, pra, grua, burri, djali, vajza dhe sa është detyrimi për ta?

(Ndërhyrje ma mikrofon)

Praktikisht për këtë kategori po flasim. Nëse bashkëshorti që ka vuajtur burgun politik nuk jeton më, grua, djali, vajza që i përkasin këtij trangu...

Arben Ahmetaj – Me falni! Të gjithë trashëgimtarët janë të përfshirë në 11 mijë dosje, se çfarë janë niveli i parë dhe i dytë në këto 11 mijë dosje edhe këtë statistikë mund t’jua vëmë në dispozicion para ditës së enjte.

Erion Braçe – Zoti Ministër, kam edhe një pyetje të fundit, praktikisht ju me këtë ligj ndërhyni në nenin 8 të ligjit bazë, i cili përcakton rrethin e familjarëve....

Në pikën 1 të këtij ligji thuhet se në kuptim të këtij ligji me “familjarë” nënkuptohen, pavarësisht nga rregullimet e tjera ligjore, ky ligj përcakton një rreth të vetin të familjarëve, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit... Ju keni shtuar një pikë, por unë kam pyetje për dy pikat ekzistuese, të cilat nuk cenohen nga ligji i ri që keni miratuar.

Pra, po lexoj edhe një herë se në kuptim të këtij ligji me “familjarë” nënkuptohen, pavarësisht nga rregullimet e tjera ligjore... pra, ky formulim krijon një rreth tjetër familjarësh, pavarësisht përcaktimeve të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, që i bie djali, vajza, nipi, mbesa dhe pastaj vazhdon “vëllezërit dhe motrat e ish- të dënuarit politik, si dhe fëmija dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, dhe pastaj vazhdon, familjarët në shkallë të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.

Tani, pyetja ime është: Në gjykimin tuaj ose në një analizë që u bëni këtyre formulimeve ligjore dhe rregulimeve të tjera të bëra me ligj, a ju duket normale që dëmshpërblimi të arrijë

deri te fëmija dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të atij që është përndjekur apo ka bërë burg politik?

Arben Ahmetaj – Besoj se po më pyesni për një këndvështrim personal dhe jo këndvështrim zyrtar, sepse këndvështrimi zyrtar përfaqësohet nëpërmjet ligjit...

Erion Braçe – Për sa kohë ju nuk e keni prekur këtë pikë, jam shumë i qartë se cili është këndvështrimi juaj. Problemi është nëse ka sens kjo gjë apo nuk ka, sepse, me thënë të drejtën, zoti Ministër, pavarësisht se kush është në pushtet, është Sali Berisha apo është Edi Rama, paratë janë para që krijohen nga taksat dhe tatimet e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Arben Ahmetaj – Zoti Braçe, nëse më pyesni mua drejtpërdrejt si Arben Ahmetaj, por edhe si kolegu juaj në parlament, unë do të thosha që paratë e buxhetit të shtetit duhet të shkojnë tek e ardhmja më shumë se tek e kaluara. Paratë e buxhetit të shtetit duhet të furnizojnë të drejtën e atyre që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dhe të rrethit të parë, të atyre që janë të lidhur drejtpërsëdrejti me ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti.

Pastaj, po të fillojmë të shtojmë radhët për arsye politike, vëllai, motra dhe djali i vëllait dhe i motrës, pra trashëgimtar pas trashëgimtari, në këndvështrimin tim personal do të duhej të kishim dhe të kemi një trajtim më të kujdesshëm me trashëgimtarët, sepse në këtë vend po të tentojmë të hapemi me politika dëmshpërblyese si këto, që nuk kanë cak, do të bëjmë që brezat e 100 vjetëve që vijnë të punojnë për brezat e 100 vjetëve të shkuara.

Këtë e kam bindje personale edhe në debatin politik, prandaj ju e keni dëgjuar atë që kam si qëndrim dhe atë që mundohem nëpërmjet instrumenteve që ka ministri i Financave të kaloj në politikat buxhetore apo ajo që avancon Kryeministri në logjikën e tij të përditshme, buxheti duhet të fokusohet më shumë tek e ardhmja, se sa tek e kaluara. Sot ka akoma shumë shpenzime që i kthehen të kaluarës dhe kur e them këtë nuk jam duke iu referuar fondit të pensioneve. Investimi te fondi i pensioneve është investim për të ardhmen, kujdesi për brezin e tretë është investim për të ardhmen. Ai që paguan sot për fondin e pensioneve praktikisht është duke investuar për të ardhmen, jo vetëm të veten, por edhe të bashkësisë qytetare të një vendi, ndërsa të vazhdosësh me kalvarin e dëmshpërblimeve, nuk po them janë të drejta apo të gabuara, nuk i hyj fare asaj, pa limite, me 600 milionë në një vend, 800 milionë në një vend, pra 600 milionë për ish- të përndjekurit, 800 e kusur për ish-pronarët, e theksoj, i bie që brezat e 100 vjetëve që vijnë të punojnë për brezat e 100 vjetëve të shkuara dhe nuk besoj se është e drejtë.

Erion Braçe – Faleminderit edhe për përgjigjen, pavarësisht se plan personal, zoti Ministër! E thashë; është një shqetësim që vjen e mbarset jo vetëm nga raste, që me thanën të drejtën janë banale, tërësisht mbi kurrizin atyre që duhet të përfitojnë realisht dëmshpërblimin si të përndjekur politikë, trashëgimtarëve të tyre, kur historia shkon tek djali i vajzës, djali i motrës e ku di unë. Të them të drejtën janë raste, të cilat po kursehem për të mos i bërë publike, sepse janë vërtet shumë të rënda, që gjejnë hapësirë jo vetëm në këtë administratën tonë gjyqësore, por gjejnë hapësirë edhe në institucione të tjera. Kjo është e para.

E dyta: pa asnjë lloj diskutimi unë mendoj se duhet të jetë në vëmendjen e gjithkujt që, sa më parë që të jetë e mundur, ata të burgosur politikë apo të përndjekur politikë, të cilët janë ende gjallë, duhen dëmshpërblyer deri në fund. Pa diskutim edhe rrethi i parë i familjarëve të tyre. Po tashti, të shkojë deri te nipi e mbesa, kam përshtypjen se është një tejkalim i të drejtës për ta përfituar këtë gjë.

Arben Ahmetaj – Mund t’ju jap një statistikë, në lidhje me të cilën më pyetët, meqë më erdhi tani nga stafi?

Erion Braçe – Po, po.

Arben Ahmetaj – Letra me vlerë: 3, 4 miliardë lekë. Apartamente: 1, 6 miliardë lekë. Më 1994 janë favorizuar në privatizim drejtpërsëdrejti, si dhe u është dhënë kesh në dorë, por këtë statistikë nuk e kemi. Kjo do të thotë se vetëm këtu i kemi edhe një pesëdhjetë milionë dollarë të tjera, që praktikisht, shuma e dhënë kësaj kategorie shkon e rakorduar në gati 230 milionë dollarë, pra 23 miliardë lekë. 230 milionë dollarë.

230 milionë dollarë ky shtet nuk i ka shpenzuar në 30 vjet për strehimin e familjeve të reja. Nuk i ka shpenzuar.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ministër!

Ka ndonjë pyetje tjetër? Diskutime ka?

Atëherë kalojmë në votimin e projektligjit.

Së pari kemi votimin në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” të ndryshuar””.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 1. Ka ndonjë opinion? Jo.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 2. Ka ndonjë opinion?

Po, urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi – Neni 2 i këtij projektligji parashikon disa ndryshime tek neni 12 i ligjit ekzistues, konkretisht me këtë përmbajtje: “Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist do të ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 milion lekë”.

Pyetja ime ka lidhje me togfjalëshin: “në mënyrë proporcionale”. Çfarë nënkupton kjo? Në mënyrë të barabartë. Ndoshta do të ishte më mirë ta shkruanim: “në mënyrë të barabartë”, sepse është më e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse duket sikur “në mënyrë proporcionale” dhe “në mënyrë të barabartë” nuk është e njëjta gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në këtë rast mendoni se është më e përshtatshme të përdoret termi “proporcionale”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull! Faleminderit!

Erion Braçe – Ka gjë tjetër në lidhje me nenin 2?

E hedhim në votë nenin 2.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, patjetër.

Neni 3. Ka gjë tjetër për nenin 3? E hedhim në votë.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 4. Zonja Kushi, keni ndonjë gjë? Ka kush gjë tjetër? E hedhim në votë nenin 4.

Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim nuk ka.

Miratohet!

Neni 5. Kush është kundër? Nuk ka. Kush është pro? Abstenim.

Miratohet!

Neni 6. Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim projektligjin në votim, në tërësi.

Kush është kundër? Nuk ka. Pro? Abstenim?

Miratohet!

Dy gjëra shpejt e shpejt. Së pari, nga mbledhja e djeshme e kemi lënë që ju do të dërgoni informacion shtesë lidhur me xhiron dhe fitimin e kompanive të lojërave të fatit, sepse do të jetë i domosdoshëm si material për kolegët deputetë që do të diskutojnë pasnesër në seancë plenare.

Së dyti, dua të bëj një sqarim, pasi dje kam dëgjuar një deklaratë nga zyra e Presidentit të Republikës. Natyrisht, Kuvendi operon në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në kreun 4 të kësaj Rregulloreje “Procedura të veçanta”, në nenin 86 “Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji” thuhet: “1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.” Pra, kjo gjë ka ndodhur.

“2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve, nga data e fillimit të shqyrtimit, paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.” Ekzaktësisht ne e kemi marrë në shqyrtim menjëherë, ashtu siç ju e evidentuat gjatë seancës së punës së komisionit vetëm për çështjen e ngritur nga Presidenti i Republikës. Madje ne kemi marrë leje kur folëm për thelbin e ligjit, për shkak se dekreti i Presidentit të Republikës, më lejoni ta përsëris edhe një herë, materialisht dhe fizikisht ishte i vërtetë, por në përmbajtje ishte i rremë. Pavarësisht këtij fakti, ne kemi marrë leje për të folur për thelbin e ligjit dhe i jemi referuar atij fakti të rremë që është në dekretin e Presidentit. Natyrisht e kemi përgatitur që dje raportin për ta kaluar në seancë plenare, pa pritur fundin e 8 javëve. Kaq thuhet në Rregulloren e Kuvendit dhe asgjë tjetër.

Ky komision nuk ka asnjë detyrim tjetër në raport me dekretin e Presidentit të Republikës për aq sa përcaktohet në Rregulloren e Kuvendit. Zero gjë tjetër! Kush kërkon mbi Rregulloren e Kuvendit, pa asnjë diskutim duhet të interesohet pranë administratës së Kuvendit, në rast se dëshiron të jetë prezent, në rast se dëshiron të marrë fjalën, në rast se dëshiron të diskutojë e kështu me radhë.

Në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni kam vetëm këtë detyrim, ashtu siç kam edhe precedent të qartë të këtij komisioni që janë aplikuar *mot a mot* gjatë mbledhjes së djeshme të komisionit.

Së fundi, meqenëse i kam lexuar deklaratat politike pas mbledhjes së komisionit, po e përsëris edhe një herë: ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” ka në thelb të tij uljen e tatimfitimit për biznesin e vogël dhe të mesëm nga 15% në 5% për xhirot vjetore deri në 14 milionë lekë të rinj; ka uljen e tatimfitimit për shoqëritë e bashkëpunim bujqësor dhe blegtoral, një formë e re kooperimi që po gjen vend në fshat dhe që duhet stimuluar me politika nxitëse nga ana e qeverisë dhe uljen e tatimfitimit nga 15% në 5% për të gjithë sektorin e agroturizmit. Pjesa tjetër është e vjetër, është e vitit 2015, kur Presidenti i Republikës dhe i gjithë grupi i tij parlamentar, përfshirë edhe zotin Petrit Vasili, kanë votuar pro ndryshimeve që janë bërë në atë ligj. Kjo histori mbaron këtu. Historia tjetër vjen me radhë, kur të përmbushen të gjitha detyrimet e tjera nga data 1 janar i vitit 2019.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

MBYLLET MBLEDHJA